

2052

125/5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Tiranë, më 30.08.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje

Drejtuar: Dorian Matlija
Drejtor Ekzekutiv i Qendrës "Res Publika"

Në lidhje me ankesën tuaj për refuzim për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, më poshtë ju paraqesim të gjitha argumentet ligjore ku e kemi mbështetur përgjigjen tonë për katër pikat e kërkesës suaj:

1. *Sa është numri i përgjimeve në procedimet penale referuar periudhës 2015 - 2022?*

Policia e Shtetit nuk disponon të dhëna statistikore për përgjimet në kuadër të procedimeve penale, për arsye se, në bazë të neneve 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, ky veprim hetimor është atribut i organit të ndjekjes penale që është Prokuroria.

2. *Sa është numri i përdorimit të përgjimit parandalues gjatë periudhës 2015 -2022?*

Bazuar në Vendimin e Ministrit të Brendshëm nr. 2, datë 08.04.2022, "Për disa shtetas dhe ndryshime në Vendimin nr. 1, datë 17.11.2021 të Komisionit të Klasifikimit të Informacionit "Sekret shtetëror", "Për listën e informacioneve të klasifikuara", "sekret shtetëror" në Ministrinë e Brendshme dhe në strukturat në varësi të saj, si dhe në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1531, datë 24.10.2014, "Për hartimin e Statistikave të kriminalitetit", pika 35, statistika e përgjimeve parandaluese është informacion i klasifikuar "sekret shtetëror".

Bazuar në Ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", ndryshuar, në nenet 19 dhe 21, përcaktohen rregullat dhe e drejta e njohjes me informacionin e klasifikuar që prodhojnë dhe administrojnë institucionet shtetërore.

3. *Cilat janë pajisjet e realizuara për realizimin e përgjimeve?*

Bazuar në Bazuar në Vendimin e Ministrit të Brendshëm nr. 2, datë 08.04.2022, "Për disa shtetas dhe ndryshime në Vendimin nr. 1, datë 17.11.2021 të Komisionit të Klasifikimit të Informacionit "Sekret shtetëror", "Për listën e informacioneve të klasifikuara", "sekret shtetëror" në Ministrinë e Brendshme dhe në strukturat në varësi të saj, në nr. rendor. 69, të Listës pjesë të këtij vendimi përcaktohet se, pajisjet dhe aparatat speciale, parametrat teknik dhe inventari i tyre në strukturat e Mbështetjes Teknike Shkencore në Departamentin e Policisë Kriminale është informacion i klasifikuar "sekret", me afat ruajtje të klasifikimit 10 vjet.

Edhe për këtë pikë të kërkesës jemi në kushtet e ndalimit që përcaktohen në Ligjin për Informacionin e Klasifikuar "sekret shtetëror".

4. *A janë realizuar përgjime me pajisje të ndaluara? Nëse po, çfarë ka ndodhur me pajisjet në fjalë?*

Përgjigja është jo.

Policia e Shtetit kryen përgjime vetëm me autorizimet e Prokurorisë dhe Gjykatës, nga të cilat përcaktohen edhe pajisjet tekniko-shkencore që do të përdoren.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Koordinatori për të Drejtën për Informim

Gentian Mullaj
